

# EPOKA

**ERE**

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8256  
E enjte, 5 mars 2026  
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja dhe Izraeli  
zotohen se nuk do të  
ndalen kundër Iranit

FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## ORËT E FUNDIT, VENDIMTARE PËR PRESIDENTIN



Kosova ka hyrë në orët e fundit vendimtare për zgjedhjen e presidentit/es. Deri më tani partitë politike parlamentare nuk kanë arritur marrëveshje për një emër konsensual për president të Kosovës. Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka thënë se Kosova nuk shkon automatikisht në

zgjedhje të parakohshme nëse nuk zgjedhet presidenti deri më 5 mars. Ai thotë se procedura për zgjedhjen e presidentit konsiderohet e nisur vetëm kur në rend dite të seancës së Kuvendit vendosen së paku dy kandidatë të propozuar me nënshkrime për president

### AKTUALE



**PRESIDENTI I SHQIPËRISË  
DEKRETON NDRYSHIMET  
NË QEVERINË RAMA** F. 3

**KRYEQYTETI ME HAPA KONKRETË  
PËR FORCIMIN E SIGURISË NË  
SHKOLLA** F. 6

**QASJE E LARTË E EKONOMIVE  
FAMILJARE NË TIK** F. 7

### EKONOMI



**FAZA E DYTË E LIBERALIZIMIT  
TË TREGUT TË ENERGJISË:  
NGA 1 PRILLI 2026 BIZNESET  
KALOJNË NË TREG TË HAPUR** F. 8

**KOSOVA E SHQIPËRIA ZOTOHEN  
PËR THELLIM TË BASHKËPUNIMIT  
PËR AUDITIME** F. 8

### SPORT



**FFK-ja PRANOHEM NË KONVENTËN  
E UEFA-S PËR LICENCËN 'FITNESS B'**  
F. 11



**RUTTE:  
DO TË SIGUROHEMI  
QË KFOR-I TË MBETET  
I FUQISHËM DHE I AFTË  
PËR TA PËRMBUSHUR  
MISIONIN** F. 7

**DREJT  
ZGJEDHJEVE.  
EDHE NJË  
HERË** F. 3

Shkruan: Petrit  
SELIMI



**RENOVA**  
PUTZ

Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289

E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE

INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**

[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
[info@kolegji.biznesi.com](mailto:info@kolegji.biznesi.com)  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency

Endrit Shaqiri  
+38344685122

Internet Website,  
Marketing...



# SHBA-ja DHE IZRAELI ZOTOHEN SE NUK DO TË NDALEN KUNDËR IRANIT



UASHINGTON, 4 MARS - Shtetet e Bashkuara dhe Izraeli u zotuan se nuk do të lëshojnë pe në fushatën e tyre ushtarake kundër Iranit teksa Tel Avivi lëshoi “valë të re të sulmeve” dhe presidenti amerikan, Donald Trump, tha se Teherani “do të goditet dhe lëndohet edhe më tepër” në ditët në vazhdim. “Goditjet e shkallës së gjerë nisin tani”, ka thënë Trumpi në Shtëpinë e Bardhë, gjatë një takimi me kancelarin gjerman Friedrich Merz. “Ata nuk kanë më mbrojtje ajrore, ata nuk kanë më sisteme gjurmimi, kështu që do të lëndohen shumë”, ka paralajmëruar presidenti amerikan. Trumpi ka përsëritur se, përveç liderit suprem Ali Khamenei, një pjesë e mirë e udhëheqjes iraniane është vrarë në sulmet amerikano-izraelite, duke e lënë regjimin në duar të pasigurta. “Shumica e njerëzve që kemi pasur në mendje tanimë janë të vdekur. Tani e kemi një grup tjetër. Edhe ata mund të jenë të vdekur, bazuar në raportime”, ka thënë Trumpi.

## “Tronditje dhe habi”

Pasi Trumpi foli, shefi i Komandës Qendrore të ushtrisë amerikane, admiral Brad Cooper, ka thënë se Operacioni “Tërbimi Epik” përbën pozicionimin më të madh të ushtrisë amerikane në Lindje të Mesme brenda një gjenerate. Ai ka thënë se

mbi 50 000 trupa, mbi 200 aeroplanë luftarakë, dy aeroplanmbajtëse dhe bombarduese me rreze të gjatë janë të përfshira në operacion. Cooper e ka përshkruar fazën hyrëse të fushatës ushtarake si dyfish më të madhe sesa ajo e vitit 2003 “Tronditje dhe habi” në Irak. “Sot nuk e kemi asnjë anije iraniane në ujërat e Gjirit Arab, Ngushticën e Hormuzit apo Gjirin e Omanit”, ka thënë Copper, duke e përshkruar atë që e ka quajtur përpjekje të pashembullt për t'i eliminuar aftësitë e Iranit që t'i kërcënojnë forcat amerikane. “Ky është vetëm fillimi”, ka thënë admiral. “Por, besoj shumë që ne, bashkë me aleatët, do t'i arrijmë objektivat tanë ushtarakë”. Copper ka thënë se ushtria amerikane i ka shkatërruar 17 anije të marinës iraniane - përfshirë një nëndetëse - dhe i ka rrëzuar gati 2 000 targete nëpër Iran brenda katër ditësh.

## Sulme të reja izraelite

Ndaras, Izraeli ka thënë më 4 mars se ka nisur “valë të re sulmesh”, duke thënë se shënjestrat e saj në ditën e pestë të sulmeve të përbashkëta amerikano-izraelite përfshijnë “sisteme ajrore iraniane, zonat e lansimit dhe infrastrukturë shtesë”. Në Teheran, qytet me rreth 10 milionë banorë, rrugët janë

parë pa njerëz, ose në disa pjesë janë parë duke u larguar nga qyteti. “Ka aq pak njerëz, prandaj krijohet përshtypje që askush nuk jeton këtu”, ka thënë infermierja Samireh për agjencinë e lajmeve AFP. Autoritetet u kanë bërë thirrje njerëzve që të largohen nga kryeqyteti. Policia, forcat e armatosura të sigurisë dhe pajisje të armatosura janë stacionuar në rrugët kryesore, duke kryer kontrolle të rregullta nëpër makina, ka shtuar AFP. Raportimet brenda Iranit vështirë verifikohen. Agjencia e lajmeve HRANA, me seli në Shtetet e Bashkuara ka thënë se gati 1 100 civilë, përfshirë 181 fëmijë, janë vrarë në sulme.

## Sirena nëpër Izrael

Ndërkohë në Izrael, sirenat ajrore janë dëgjuar gjatë gjithë natës, teksa ushtria izraelite ka bërë përpjekje që t'i ndalë sulmet iraniane. Policia në Tel Aviv ka thënë se një grua është plagosur nga një predhë që ka rënë. Nuk ka raportime për viktima tjera izraelite. Izraeli, po ashtu, i ka nisur sulmet kundër elementëve të Hezbollahut - aleatit të Iranit - në Bejrut, pasi krah u shtrarak i grupit ka gjuajtur raketa në veri të Izraelit. Hezbollahu konsiderohet organizatë terroriste nga ShBA-ja. Shpërthime të mëdha janë

## Nathan Sales: Suksesi në Iran do të matet nga ritmi i rënies së sulmeve iraniane

Objektivat e Uashingtonit në luftën me Iranin janë ushtarake dhe politike, duke përfshirë neutralizimin e kërcënimit që Teherani paraqet për Shtetet e Bashkuara dhe aleatët, si dhe krijimin e kushteve për ndryshim politik brenda vendit, sipas Nathan Sales, ish-ambasadori i ShBA-së i ngarkuar për luftë kundër terrorizmit, i cili tani është bashkëpunëtor në programet për Lindjen e Mesme në Këshillin Atlantik. Sales tha në një intervistë për Radion Evropa e Lirë se një tregues kyç afatshkurtër i suksesit do të jetë se sa shpejt do të fillojë të ulet intensiteti i

sulmeve të Iranit. Sipas tij, diçka e tillë do të tregonte se fushata amerikane po e dobëson aftësinë e Iranit për t'i vazhduar sulmet. “Unë mendoj se operacionet për t'i goditur shërbimet e sigurisë janë gjithashtu të rëndësishme, sepse ata janë elementët e regjimit që do të përpiqeshin të shtypnin çdo kryengritje të ardhshme nga populli iranian për të rikthyer demokracinë dhe lirinë në vendin e tyre”. Ambasadori Sales paralajmëroi gjithashtu se lufta mund të krijojë kërcënime sigurie edhe përtej Lindjes së Mesme.

## Bashkëpunim me kurdët?

Përtej këtyre zhvillimeve, partia kurde në pushtet në Irak ka thënë se liderët e saj kanë biseduar me Trumpin për hapat e ardhshëm në luftë kundër Iranit fqinj. Shtëpia e Bardhë nuk i ka konfirmuar raportimet, mirëpo ka thënë se “presidenti Trump ka folur me disa parterë rajonale”. Unioni Patriotik i Kurdistanit (PUK) ka thënë se Trump e ka kontaktuar kreun e partisë, Bafel Talabani për t'i diskutuar veprimet amerikane në Iranin fqinj. Mediat amerikane kanë raportuar se Trump ka biseduar edhe me liderin kurd të Irakut, Masoud Barzani një ditë pas nisjes së sulmeve të ShBA-së dhe Izraelit në Iran. Këto raportime vijnë në kohën kur e përditshmja amerikane Wall Street Journal ka shkruar se Trump është duke e konsideruar ofrimin e mbështetjes për fraksione kurde të Irakut në luftën kundër udhëheqësive iraniane. Kurdët irakianë janë një forcë e madhe në kufi me Iranin dhe kanë lidhje me minoritetin kurd në Iran. Kurdët etnikë kërkojnë me dekada shtet të pavarur dhe e akuzojnë Teheranin për shtypje të minoritetit kurd.



# RUTTE: DO TË SIGUROHEMI QË KFOR-I TË MBETET I FUQISHËM DHE I AFTË PËR TA PËRMBUSHUR MISIONIN

PRISHTINË, 4 MARS - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka deklaruar se aleanca nuk do ta lejojë krijimin e një vakuumi sigurie në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se misioni paqeruajtës në Kosovë do të mbetet "i fuqishëm dhe i gatshëm për misionin e tij". Duke folur për rolin e Maqedonisë së Veriut në kuadër të aleancës, gjatë vizitës së sotshme në Shkup, Rutte tha se stabiliteti në Ballkanin Perëndimor është me rëndësi strategjike për NATO-n. Ai falënderoi Shkupin zyrtar për kontributin në misionin e

KFOR-it në Kosovë, duke theksuar se ky mision "vazhdon të luajë rol themelor në mbështetje të sigurisë së qëndrueshme, në dobi të të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë". "Ne do të vazhdojmë të sigurohemi që KFOR-i të mbetet i fuqishëm dhe i aftë për ta përmbushur misionin", tha ai, duke shtuar se bashkëpunimi mes aleatëve është thelbësor për sigurinë e përbashkët. Misioni i KFOR-it u vendos në Kosovë në qershor të vitit 1999, pas përfundimit të luftës, me qëllim krijimin e një mjedisi të sigurt dhe parandalimin e rikthimit të dhunës. Ai mbetet



operacioni më jetëgjatë dhe një nga më të mëdhenjtë aktivë të NATO-s. Fillimisht, forca shumëkombëshe numëronte mbi 50 000 trupa, ndërsa sot ka

rreth 4 700 ushtarë. Rreth 590 prej tyre janë nga Shtetet e Bashkuara. Deklaratat e Ruttes vijnë në një kohë kur, muajt e fundit, janë shtuar diskutimet për

mundësinë e një rishikimi të angazhimit amerikan në misionet e jashtme të NATO-s, përfshirë edhe Kosovën. Megjithatë, Pentagoni ka thënë se nuk ka ndonjë njoftim për ndryshim të dislokimit të forcave në KFOR. Në Kosovë, KFOR-i vazhdon të jetë përgjegjës për sigurinë e kufirit tokësor me Serbinë dhe për garantimin e një mjedisi të sigurt, veçanërisht në veri të vendit, ku tensionet mbeten të pranishme për shkak të mungesës së njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia.

## POLICIA E KOSOVËS PARAQET RAPORTIN VJETOR 2025 TË BURIMEVE NJERËZORE: MBI 1 250 TRAJNIME DHE 11 800 PJESËMARRËS GJATË VITIT

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 MARS - Policia e Kosovës ka paraqitur raportin vjetor 2025 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në kuadër të këtij institucioni.

Raporti pasqyron punën, arritjet dhe prioritetet e departamentit gjatë vitit 2025, duke ofruar një përmbledhje të qartë të përparimit institucional dhe objektivave të realizuara.

Gjatë vitit 2025 Departamenti ka shënuar rezultate të rëndësishme në menaxhimin e burimeve njerëzore përmes avancimit të sistemit të menaxhimit dhe forcimit të mekanizmave të brendshëm. "Proceset e rekrutimit janë zhvilluar në mënyrë efikase dhe transparente, duke garantuar përzgjedhje meritore dhe profesionale. Njëkohësisht, është rritur cilësia dhe përmbajtja e programeve trajnuese, janë forcuar kapacitetet profesionale të stafit dhe është thelluar digitalizimi i proceseve administrative dhe



trajnuese, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies institucionale. Gjatë kësaj periudhe janë rekrutuar dhe trajnuar gjenerata të reja zyrtarësh policorë, si dhe janë zbatuar programe të specializuara në fusha prioritare, përfshirë hetimet, sigurinë kibernetike, inteligjencën dhe operacionet policore. Po ashtu, është zgjeruar dhe konsoliduar bashkëpunimi me partnerë ndërkombëtarë dhe vendorë", thuhet në komunikatën e PK-së. Në këtë kuadër, Divizioni i

Trajnimeve, me përkrahjen e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, gjatë vitit 2025 ka realizuar gjithsej 1 252 aktivitete trajnuese me 11 829 pjesëmarrës. "Këto aktivitete kanë përfshirë trajnime të brendshme, trajnime jashtë vendit, si dhe procese të ricertifikimit, duke kontribuar ndjeshëm në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe në përmbushjen e standardeve operative. Një fokus i veçantë gjatë vitit 2025 i është kushtuar mirëqenies së personelit, përmes ofrimit dhe forcimit të mbështetjes shëndetësore dhe

psikologjike për zyrtarët policorë dhe stafin civil. Janë zhvilluar mekanizma mbështetës për trajtimin e stresit profesional, këshillimin psikologjik dhe promovimin e shëndetit në vendin e punës, me synim ruajtjen e performancës, integritetit dhe stabilitetit emocional të personelit", theksohet në komunikatën për medie.

Mirënjohje e veçantë u shpreh për partnerët që kanë mbështetur vazhdimisht Departamentin për ngritjen e kapaciteteve profesionale. "Falë përkrahjes së tyre është mundësuar realizimi i një numri të konsiderueshëm trajnimesh dhe programesh të specializuara, të cilat kanë kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin profesional dhe ngritjen e kompetencës së zyrtarëve policorë, si dhe në forcimin e standardeve institucionale. Departamenti ka menaxhuar me efikasitet të gjitha proceset e personelit, përfshirë rekrutimin, vlerësimin e performancës, mbështetjen

shëndetësore dhe psikologjike, si dhe organizimin e aktiviteteve profesionale brenda dhe jashtë vendit. Vëmendje e veçantë i është kushtuar integritetit institucional, barazisë gjinore dhe mirëqenies së personelit, me qëllim forcimin e standardeve profesionale dhe rritjen e besimit të publikut", thuhet në komunikatën e PK-së. Raporti paraqet, gjithashtu, sfidat e hasura dhe objektivat strategjike për vitin 2026. Në kuadër të prezantimit të raportit, Departamenti i Burimeve Njerëzore ndau mirënjohje për zyrtarë që kanë kontribuar në mënyrë të veçantë në zhvillimin profesional, ngritjen e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e standardeve organizative. Në këtë takim u tha se Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për ndërtimin e një sistemi transparent, profesional dhe të përgjegjshëm të menaxhimit të burimeve njerëzore, në funksion të rritjes së sigurisë publike dhe shërbimit ndaj qytetarëve.

## Presidenti i Shqipërisë dekreton ndryshimet në qeverinë Rama

TIRANË, 4 MARS - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj, të mërkurën ka dekretuar lirimin e Ferit Hoxhës nga detyra e ambasadorit të Jashtëzakonshëm dhe Fuqiplotë të Republikës së Shqipërisë në Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit Evropian, rezident. Begaj, gjithashtu, dekretoi ndryshimet në qeveri dhe shkarkimin nga detyra të:

Belinda Balluku, zëvendës-ryeministër dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë; Elisa Spiropali, ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme; Pirro Vengu, ministër i Mbrojtjes; Albana Koçiu, ministër i Punëve të Brendshme; Besfort Lamallari, ministër i Drejtësisë; Toni Gogu, ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin. Ndërkaq presidenti Begaj

dekretoi emërimin në detyrë të: Albana Koçiu, zëvendës-ryeministër; Ferit Hoxha, ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme; Besfort Lamallari, ministër i Punëve të Brendshme; Ermal Nufi, ministër i Mbrojtjes; Toni Gogu, ministër i Drejtësisë; Enea Karakaçi, ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë; Erjona Ismaili, ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.







# ORËT E FUNDIT, VENDIMTARE PËR PRESIDENTIN

Kosova ka hyrë në orët e fundit vendimtare për zgjedhjen e presidentit/es. Deri më tani partitë politike parlamentare nuk kanë arritur marrëveshje për një emër konsensual për president të Kosovës. Ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hasani, ka thënë se Kosova nuk shkon automatikisht në zgjedhje të parakohshme nëse nuk zgjedhet presidenti deri më 5 mars. Ai thotë se procedura për zgjedhjen e presidentit konsiderohet e nisur vetëm kur në rend dite të seancës së Kuvendit vendosen së paku dy kandidatë të propozuar me nënshkrime për president

**PRISHTINË, 4 MARS** - Numrat, afatet dhe mungesa e konsensusit kanë kthyer çështjen e zgjedhjes së presidentit të Kosovës në një provë të funksionimit institucional. Teksa partitë po i llogarisin votat janë shfaqur paqartësi rreth asaj nëse pjesëmarrja dhe votimi në seancën për presidentin përbëjnë obligim për deputetët, apo edhe nëse moszgjedhja e presidentit nga Kuvendi çon vendin përsëri në zgjedhje të parakohshme. Çfarë thonë Kushtetuta dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese? Si e vlerësojnë njohësit e fushës këtë çështje?

Teksa nuk po gjejnë një kandidat konsensual, partitë politike nuk po pranojnë të mbështesin kandidatë partiakë. Rregullorja e Kuvendit të Kosovës parasheh që seanca për zgjedhjen e presidentit të thirret pasi të jenë dorëzuar kandidatët e nominuar, të cilët shqyrtohen nga Komisioni për Legjislacion se sa i plotësojnë kushtet e përcaktuara. Neni 86 i Kushtetutës përcakton që secili kandidat duhet t'i sigurojë 30 nënshkrime të deputetëve për t'u nominuar, dhe se deputetët mund ta japin

nënshkrimin vetëm për një kandidat. Deri më tani asnjë emër nuk është zyrtarizuar si kandidat.

## Pjesëmarrja në seancë dhe në votim

Kryeministri Albin Kurti deklaroi të hënën, pas një takimi konsultativ për çështjen e presidentit me kryetarin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, se Kushtetuta i obligon deputetët të votojnë. Ngjashëm si Kurti u deklarua edhe kryetarja e Kuvendit nga radhët e partisë së tij, Lëvizjes

Vetëvendosje (LV). Duke iu referuar aktgjykimet kushtetues për rastin e zgjedhjes së Behgjet Pacollit president në vitin 2011, Albulena Haxhiu tha si i njëjti "kërkon që të gjithë deputetët të jenë të pranishëm dhe të votojnë". Në anën tjetër, Bedri Hamza, kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), tha të hënën se partia e tij merr pjesë në zgjedhjen e presidentit, nëse kandidati i propozuar prej saj zgjedhet president. Aktgjykimi i rastit "Pacolli", të cilit i referohet LV-ja, në pikën 83 thotë se "të gjithë 120 deputetët e Kuvendit duhet të ndjehen të obliguar" sipas Kushtetutës dhe ligjeve që të marrin pjesë në seanca plenare, ndërsa pika 84 thotë se ata "duhet ta konsiderojnë si detyrë kushtetuese të tyre" zgjedhjen e presidentit. Ehat Miftaraj, nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, thotë për Radion Evropa e Lirë se në këtë rast, gjykata ua rikujton deputetëve obligimet që kanë sa i përket funksionimit demokratik të institucioneve,

por pa i detyruar si të veprojnë. Kjo çështje ishte sqaruar në aktgjykimin tjetër të Kushtetueses, për rastin e zgjedhjes së Hashim Thaçit president në vitin 2016, kur LV-ja, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nisma Socialdemokrate kishin kërkuar që zgjedhja e tij të shpallej antikushtetuese, me arsyetimin se nuk kishin marrë pjesë 120 deputetë në votim dhe se s'ishte përmbushur kuorumi. Pika 74 e atij dokumenti kishte dalë në përfundim se nuk është as parakusht, dhe as kërkesë kushtetuese, që të gjithë 120 deputetët të jenë të pranishëm dhe të votojnë, për të qenë i vlefshëm vendimi i zgjedhjes së presidentit. Sipas Miftarajt, askush nuk mund të ndikojë në vullnetin e lirë të deputetit, nëse dëshiron ta bëjë kuorumin në seancë apo jo. "Në demokracitë liberale, nuk ka Gjykatë Kushtetuese që mundet t'i tregojë, apo ta obligojë deputetin si të votojë dhe a të marrë pjesë në seancë apo jo."



# DREJT ZGJEDHJEVE. EDHE NJË HERË



Shkruan: Petrit SELIMI

Albin Kurti është lideri i parë partiak në historinë e demokracisë kosovare që ka opsione të shumëfishta me zgjedhë presidentin/en e republikës. Mundet me ia zgjatë mandatin presidentes në shkuarje Vjosa Osmanit, me ndihmën e LDK-së. Mundet me u marr vesh për ndonjë kandidat tjetër me LDK-në. Kurti mundet për ta injoruar si LDK-në ashtu edhe Osmanin dhe me u marrë vesh me PDK-së për një kandidat që i konvenon dhe

që i merr 80 vota. Kryeministri omnipotent i Kosovës ka edhe opsion tjetër: mundet për të propozuar një emër neutral konsensual që nuk është fare i përfshirë në politikë. Ndonjë profesor apo diplomat karriere apo aktivist nga shoqëria civile me integritet njerëzor.

Ja që asnjëra nga opsionet, ku Kurtit i kërkohet të bën një kompromis fare të vogël që të përmbyll krijimin e institucioneve dhe të vazhdon krejtësisht i papenguar të qeverisë si kryeministër, nuk e kënaq. Kryeministri në Kosovë, sipas sistemit tonë kushtetues, është epiqendra e qeverisjes, zbatimit të vendimeve, formësimit të politikave. Si kryeministër me një mandat të fuqishëm prej 51 %, Kurti e ka luksin për ta drejtuar procesin e zgjedhjes së presidentit tek personat që realisht nuk kanë asnjë rol ekzekutiv e as mundësi

teorike për të konkurruar politikisht.

Por jo. Regjimi i Vetëvendosjes ka vendosur ta bllokoi Osmanin. Ka vendosur po ashtu ta bllokoi çfarëdo marrëveshje me LDK-së apo PDK-së. Në botën e kryeministrit kosovar nuk ka vend për çfarëdo kompromisi, sado minimal të jetë ai, për të mirë të Kosovës, nëse shoh çfarëdo rreziku që ia mohan të drejtën që ai dhe vetëm ai të jetë i vetmi që dominon tërë qeverinë, tërë Kuvendin dhe tërë institucionet.

Këtë të drejtë kryeministri ka filluar të proklamonte se e ka “të shkruar” nga Zoti. E tha pardje me gojë të vetë: “Zoti me laps” - God himself - ia dha 51.1 %. Thjesht teologjikisht, kjo është natyrisht një blasfemi, por deklarata e Kurtit për “mandatin hyjnor” tradhton se çka në të vërtetë sillet në mendjen e kryeministrit: ta krijon Republikën e Tretë ku

s’ka vend për askënd që nuk e kalon testin e puritanizmit të Pejgamberit Kurti.

Problemi është që kjo Republika e Dytë, republika reale dhe ekzistente, jo imagjinare, e ka një trashëgimi politike dhe sistem juridik ku populli voton për qeverinë dhe ai që e bën shumicën e thjeshtë qeveris me vend e kuvend por presidenti/ja ka nevojë për konsensus më të gjerë të shumicës së 2/3 të deputetëve. Kjo nuk është pahiri. Ky sistem juridik dhe traditë demokratike me qëllim është dizajnuar e kultivuar për të krijuar koalicione dhe për të inkurajuar kompromise. Republika e Dytë, kjo realja, ekzistuesja, për të cilën u derdh gjak dhe për të cilën lidhëm besëlidhje me Amerikë dhe aleatë, i konsideron koalicionet dhe kompromiset vlerë.

Kurtit i takon me udhëheq qeverinë i vetëm dhe për ta

kontrolluar Kuvendin i vetëm. Por për Presidencë i nevojiten votat e tjerëve.

Kurti nuk do t’i kërkon votat e kurrkujt sepse e konsideron 51.1% të vetëmjaftueshëm për vetëkënaqje. Kurti nuk e ka as problem me blloku krejt një Republikë (këtë të Dytën, realen, ekzistenten), krejt një shoqëri, krejt një shtet. Bile në bllokadë, krizë, kaos, noton si peshku në ujë.

Dhe kështu fituesi historik i mandatit më të thellë ndonjëherë të fituar nga populli për me qeverisë, ka vendosë vullnetarisht, me “mend në krye” siç themi popullorçe, me abdiku prej qeverisjes, prej përgjegjësisë, prej kompromisit e koalicioneve, për edhe një hedhje zari drejt dominimit monopartiak (e që realisht është monopersonal sepse VV është Kurti dhe vetëm Kurti). Prandaj po shkojmë drejt zgjedhjeve.

## A shkon Kosova në zgjedhje nëse nuk zgjedhet presidenti?

Në secilin deklaram rreth çështjes së presidentit, përfaqësuesit politikë përmendin shkuarjen në zgjedhje të parakohshme, në rast dështimi të zgjedhjes së kreut të shtetit.

Por, Kushtetuta, në nenin për zgjedhjen e presidentit, thotë se presidenti i ri duhet të zgjedhet 30 ditë para se të përfundojë mandati i presidentit aktual, që në rrethanat e tanishme është data 5 mars, para se Vjosa Osmani ta mbyllë mandatin e saj më 4 prill.

Miftaraj vlerëson se edhe nëse Kosova nuk e zgjedh presidentin deri më 5 mars, vendi nuk do të përballët me zgjedhje. Sipas tij, nëse nuk përmbushet ky afat 30-ditor, bëhet shkelje kushtetuese, por nuk ka pasojë juridike si shkuarja në zgjedhje.

Miftaraj thotë se nuk ekziston një nen ku mund të bazohet dekreti për shpërndarjen e Kuvendit. “Janë vetëm dy situata në të cilat shkohet në zgjedhje. E para, nëse, ta zëmë, më 5 mars fillon procesi për zgjedhjen e presidentit, dhe i njëjti nuk përmbillet brenda 60 ditësh, automatikisht vendi shkon në zgjedhje. Dhe, në situatën e dytë, nëse në rundin e tretë të votimit për president nuk janë votat e mjaftueshme për t’u zgjedhur presidenti”, sqaron Miftaraj.

Një kandidat duhet t’i sigurojë dy të tretat e votave të

deputetëve në Kuvendin me 120 karrige, ndërsa kuorumi arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t’i ketë 61.

Sipas Kushtetutës, po dështoi zgjedhja në këto tre runde, zgjedhjet e parakohshme parlamentare duhet të mbahen brenda 45 ditësh.

## Çfarë ndodh nëse nuk zgjedhet fare presidenti?

Më 5 prill, Osmani nuk do të ishte më presidente, ndërsa postin e saj do ta ushtronte kryetarja e Kuvendit, Haxhiu, jo më gjatë se 6 muaj, siç e parasheh Kushtetuta.

Nëse deri këtë të enjte nuk zgjedhet presidenti, Miftaraj vlerëson se 10 deputetë do të mund t’i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese për interpretim të situatës.

Ai konsideron se gjykata do të mund t’u kërkonte atyre të provonin zgjedhjen e presidentit para se Osmanit t’i skadojë mandati, ose në të kundërtën shkohet automatikisht në zgjedhje. “As kjo nuk ka bazë të shkruar të Kushtetutë, por Gjykata ka të drejtën e interpretimit të saj”.

Në Kosovë, presidenti përfaqëson unitetin e popullit, dhe garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë.

Do të varet nga veprimet e aktorëve politikë nëse do të arrijnë të pajtohen për një emër që ta marrë këtë rol. /REL

## Enver Hsani: Kosova nuk shkon automatikisht në zgjedhje të parakohshme nëse nuk zgjedhet presidenti më 5 mars

Kosova nuk shkon automatikisht në zgjedhje të parakohshme nëse nuk zgjedhet presidenti deri më 5 mars, thotë ish-kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Enver Hsani. Ai në një intervistë për KosovaPress thotë se procedura për zgjedhjen e presidentit konsiderohet e nisur vetëm kur në rend dite të seancës së Kuvendit vendosen së paku dy kandidatë të propozuar me nënshkrime. Sipas tij, vetëm nga ky moment fillon të rrjedhë afati 60-ditor, brenda të cilit duhet të zgjedhet presidenti. E tek, nëse brenda këtij afati nuk arrihet të votohet i pari i vendit, atëherë vendi shkon automatikisht në zgjedhje. “Procedura e zgjedhjes do të thotë kur mandati është i rregullt, duhet të bëhet 30 ditë para se të përfundojë mandati i presidentit aktual. Në çdo situatë, kurdo qoftë që fillon nesër, pas një jave, pas një muaji, kurdo qoftë që fillon dhe nuk zgjedhet brenda afatit prej 60 ditëve, prej nisjes së procedurës, atëherë shkohet me automatizëm në zgjedhje. Procedura nis në momentin kur futen në rend dite dy kandidatë, domethënë të propozuar me nënshkrime, së paku dy kandidatë, konsiderohet që ka nisur procedura. Nuk ekziston



detyrimi kushtetues dhe e thotë qartë në aktgjykimin e fundit për rastin e presidentit, kur ka qenë çështja e presidentit Thaçi. Në qoftë se nuk zgjedhet presidenti për 60 ditë, prej ditës kur nis procedura, siç e thashë, kurdo qoftë që nis ajo, atëherë shkohet në zgjedhje. Por nuk shkohet në zgjedhje për faktin që nuk është zgjedhur 30 ditë para skadimit të mandatit”, thotë Hsani.

Ai deklaron se në rast se mandati i presidentes përfundon dhe nuk ka president të zgjedhur, detyrën e ushtruesit të detyrës së presidentit e merr kryetarja e Kuvendit, në këtë rast Albulena

Haxhiu, një ditë pas skadimit të mandatit të presidentes aktuale, Vjosa Osmani. “Kurdo qoftë që nis procedura, e procedura nis kur janë vënë në rend dite së paku dy kandidatë, konsiderohet nisje e procedurës. Në qoftë se ajo është nisur sot, prej sotit kur mbushen 60 ditë, atëherë me automatizëm duhet të shpallen zgjedhjet. Dhe ajo nënkupton, në rastin konkret, atë duhet ta bëjë zonja Albulena Haxhiu, sepse Albulena Haxhiu po ashtu me automatizëm e merr postin e ushtruesit të detyrës së presidentit, ditën e nesërme që i skadon mandati zonjës Osmani”, ka deklaruar Hsani.



## Kryeqyteti me hapa konkretë për forcimin e sigurisë në shkolla

**PRISHTINË, 4 MARS** - Drejtori për Siguri dhe Emergjencë në komunën e Prishtinës, Lulzim Fushtica, ka paraqitur të mërkurën raportin e përgatitur nga drejtoria, ku janë identifikuar problematikat dhe sfidat me të cilat përballen shkollat e kryeqytetit. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se në kuadër të këtij procesi janë

inspektuar mbi 60 objekte shkollore, duke vlerësuar sigurinë fizike dhe gjendjen e infrastrukturës. “Nga këto inspektime janë identifikuar një sërë problemesh, për të cilat kryeqyteti do të ndërhyjë drejtpërdrejt, ndërsa njëkohësisht do të kërkojë llogaridhënie nga menaxhmentet e shkollave. Për të garantuar standarde të qëndrueshme sigurie, inspektimet do të

realizohen çdo gjashtë muaj, ndërsa për çështjet e sigurisë që janë në përgjegjësi të menaxhmentit të shkollave do të kërkohej përgjegjësi dhe veprim i menjëhershëm. Siguria fizike, mendore dhe emocionale e nxënësve dhe e stafit mësimdhënës mbetet prioritet i panegociueshëm për kryeqytetin”, ka thënë Rama.



## UP-ja ZGJIDH NJË PROBLEM TË MADH, ZHVENDOSSET SHTYLLA E TENSIONIT TË LARTË PRANË OBJEKTIT TË FAKULTETIT TË BUJQËSISË DHE VETERINARISË

**PRISHTINË, 4 MARS** - Puna e pandërprerë e menaxhmentit të UP-së dhe drejtuesve të Fakultetit të Bujqësisë e Veterinarisë (FBV), ka mundësuar që të zhvendoset shtylla e tensionit të lartë pranë objektit të ri. Zyra e Rektorit, prof. Arben Hajrullahu, në bashkëpunim të ngushtë me menaxhmentin e FBV-së dhe falë përkushtimit e angazhimit maksimal ndërinstytucional, ka arritur me sukses ta realizojë zhvendosjen e shtyllës së tensionit të lartë që ndodhej pranë ndërtesës së objektit të ri. Pas më shumë se dhjetë vjetësh mosfunksionimi, është hapur mundësia që objekti i ri i FBV-së të vihet në shfrytëzim nga UP-ja pas largimit të shtyllës së

tensionit të lartë ndërkombëtar, respektivisht telave të rrymës në afërsi të objektit. Ky hap i rëndësishëm garanton siguri më të madhe infrastrukturore dhe krijon parakushtet e nevojshme për funksionalizimin e plotë të objektit të ri. Objekti i ri i këtij fakulteti kishte mbetur i braktisur, ndër të tjera, pasi ishte ndërtuar fare pranë shtyllës së tensionit të lartë elektrik. Për më shumë, kjo shtyllë nuk mund të largohej edhe për shkak të depove të KEDS-it të vendosura në pronën e UP-së. Personeli i UP-së u detyrua të bllokojë fizikisht e me mjete të rënda hyrjen në këto depo, ndërsa rektori, prof. Arben Hajrullahu, për të sqaruar



situatën, mbajti edhe një konferencë për gazetarë më 5 dhjetor 2025. Ai atëherë alarmoi për mundësinë reale që FBV-ja

të mos akreditohej për mungesë hapësire. Edhe pse ndërkohë KEDS-i ka larguar depot nga hapësirat afër

objektit të ri të FBV-së, aty pranë vazhdohej shfrytëzimi i paautorizuar i pronave të UP-së nga ndërmarrje afariste. Rektori prof. Arben Hajrullahu apelon tek organet kompetente të ndërmarrin menjëherë veprimet e nevojshme për lirim të pronave të Universitetit të Prishtinës. Pa lirim edhe të pronave të tjera pranë objektit të ri Fakultetit të Bujqësisë e Veterinarisë nuk do të jetë i mundur funksionalizimi i objektit të këtij fakulteti. Objekti i ri i FBV-së, i mbetur për më shumë se një dekadë nën mëshirën e kohës, kërkon investime shtesë që të mund të funksionalizohet, në mënyrë që të pranojë studentët e rinj dhe ata ekzistues në shtator të vitit akademik 2026/’27.

## ZYRA PËR RIKTHIMIN E ASETETEVE DHE ZYRA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR DROGËN DHE KRIMIN DISKUTOJNË PËR FORCIMIN E BASHKËPUNIMIT



**PRISHTINË, 4 MARS** - Udhëheqësi i Zyrës për Rikthimin e Aseteve (ZRA), njëherësh prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, priti në takim përfaqësuesen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, Jasna Pekiq. Gjatë takimit u diskutuan çështje me rëndësi në fushën e rikthimit të asetëve, përfshirë

avancimin e infrastrukturës ligjore, shkëmbimin e përvojave praktike ndërmjet zyrave për asete të Ballkanit Perëndimor, si dhe mundësitë për forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional. Po ashtu, u shqyrtua mundësia e organizimit të një vizite studimore në njërin nga zyrat për rikthimin e asetëve në

shtetet e Ballkanit Perëndimor. Hyseni e falënderoi Pekiqin për mbështetjen dhe angazhimin e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, ndërsa të dyja palët u shprehën të gatshme që takimet dhe koordinimi të vazhdojnë edhe në të ardhmen, me synim arritjen e rezultateve konkrete në këtë fushë.

## Kryetari i Drenasit ngushëllon familjen Maliqi për ndarjen nga jeta të humanistit Mentor Maliqi

**DRENAS, 4 MARS** - Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka ngushëlluar familjen Maliqi nga Korrotica e Ulët e Drenasit, me rastin e ndarjes nga jeta të humanistit Mentor Maliqi. “Me dhimbje të thellë mora lajmin për ndarjen nga jeta të humanistit Mentor Maliqi nga Korrotica e Ulët.

Me veprat dhe përkushtimin e tij ndaj njerëzve në nevojë, ai la gjurmë të respektuara në shoqërinë tonë dhe në kujtesën e të gjithë atyre që patën rastin ta njohin. Në këto çaste të vështira për familjen Maliqi, në emrin tim personal dhe në emër të Komunes së Drenasit, shpreh

ngushëllimet më të sinqerta për familjen, të afërmit dhe miqtë”, shtoi tutje kryetari Lladrovci. Ai ka theksuar se kujtimi për humanistin Mentor Maliqi do të mbetet gjithmonë i nderuar dhe i paharruar. “I lehtë i qoftë dheu i Kosovës!”, ka thënë Lladrovci.





## Drejtuesit e IKD-së avokojnë për zbatimin e rekomandimeve në Gjykatën Komerciale

PRISHTINË, 4 MARS - Drejtuesit e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, Betim Musliu dhe Gzim Shala, kanë takuar kryetarin e Gjykatës Komerciale, Mahir Tutuli, me qëllim të dorëzimit të raporteve të monitorimit dhe hulumtimit sistematik të sistemit të drejtësisë në vend si

dhe për të avokuar për zbatimin e rekomandimeve të dala nga këto raporte. Kryetari i Gjykatës Komerciale, Tutuli, ka vlerësuar punën e IKD-së në monitorimin dhe hulumtimin e funksionimit të sistemit të drejtësisë, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me shoqërinë

civile në forcimin e transparencës dhe sundimit të ligjit. IKD në vazhdimësi ka avokuar pranë të gjithë aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe sigurisë duke dërguar raportet me gjetjet, vlerësimet dhe rekomandimet konkrete, si dhe duke zhvilluar takime me

zyrtarët përgjegjës në institucionet përkatëse. Qëllimi i këtij angazhimi mbetet shtyrja përpara e politikave që rrisin efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të drejtësisë dhe sigurisë, si dhe mundësimi i realizimit të të drejtave të qytetarëve dhe qasjes së tyre në drejtësi.



## KUSARI-LILA NËNSHKRUAN VENDIMIN QË RREGULLON ÇMIMET E NAFTËS NË TREGUN E KOSOVËS

PRISHTINË, 4 MARS - Ministria e Tregtisë, Mimoza Kusari-Lila, ka nënshkruar vendimin për caktimin e çmimeve të produkteve të naftës pas rritjes së menjëhershme të çmimeve të derivateve si rrjedhojë e ngjarjeve në Lindjen e Mesme. Ministria e ka quajtur këtë vendim të domosdoshëm. “Sot nënshkrova vendimin për caktimin e çmimeve të produkteve të naftës, pas rritjes së menjëhershme të çmimeve të derivateve si rrjedhojë e ngjarjeve në Lindjen e Mesme. Ky vendim ishte i domosdoshëm për mbrojtjen e konsumatorëve dhe garantimin e konkurrencës së drejtë e të



ndershme në tregun vendor. Vendimi vjen pas mbikëqyrjes së vazhdueshme të tregut të

naftës, analizimit të evidencave ditore nga Dogana e Kosovës dhe raporteve të

Inspektoratit Qendror të Mbikëqyrjes së Tregut, ku është konstatuar se rritjet e çmimeve nga importi janë reflektuar menjëherë në çmimet e shitjes. Marzha tregtare maksimale e lejuar: Shitja me shumicë: deri në 2 euro centë për litër dhe shitja me pakicë: deri në 12 euro centë për litër”, ka thënë Kusari-Lila. Ajo ka bërë me dije se inspektorët do të jenë në terren për ta mbikëqyrur zbatimin e këtij vendimi. “Llogaritja e marzhës tregtare maksimale të lejuar për shitje me shumicë dhe pakicë bëhet sipas nenit 4, paragrafi 1.1 dhe 1.2, të Udhëzimit Administrativ Nr. 03/2022 për

Rregullimin e Çmimeve të Produkteve të Naftës dhe Karburanteve të Ripërtëritshme dhe Masat e Tjera Mbrojtëse. Duke u bazuar në analizën e situatës në treg dhe në kompetencat ligjore të Ministrisë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi një (1) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Çdo shkelje apo moszbatim i këtij vendimi do të trajtohet sipas legjislacionit në fuqi. Ky vendim synon të sigurojë konkurrencë të ndershme dhe mbrojtje të konsumatorëve në tregun e Republikës së Kosovës”, ka thënë Kusari-Lila.

## SVEÇLA E AKUZON ISH-SHEFIN E BIA-s SERBE PËR DEKLARATA KËRCËNUESE KUNDËR KOSOVËS

PRISHTINË, 4 MARS - Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, e ka kritikuar të mërkurën ish-shefin e shërbimit sekret të Serbisë, Aleksandar Vulin, për deklarata “të papranueshme dhe thellësisht kërcënuese” ndaj vendit të tij dhe kryeministrit Albin Kurti. Në një video të shpërndarë në “Facebook” nga Sveçla, Vulin më sa duket bën thirrje që Serbia të veprojë kundër Kosovës njëllor siç kishte vepruar agjencia izraelite e inteligjencës, Mossad, në Iran, duke thënë “kur mundet Izraeli, pse nuk mundemi edhe ne”. Më pas, ai thotë se inteligjenca serbe duhet të përpilojë plan për t’u marrë me “bartësit e politikave kundër Serbisë”, duke e përmendur me emër kryeministrin e Kosovës, Kurti.

Sveçla tha se imponimi i një analogjie nga një konflikt me luftë të hapur, kërcënime të armatosura dhe operacione të shpallura kundër aktorëve të konsideruar armiq, dhe t’i aplikosh ato në raport me kryeministrin e Kosovës, “nënkupton normalizimin e logjikës së operacioneve sekrete si mjet kërcënimi dhe destabilizimi të drejtpërdrejtë në Ballkan”.

Vulin ka shërbyer për disa vjet ministër i Mbrojtjes i Serbisë dhe pastaj shef i BIA-s. Në vitin 2025 ai gjeti punë të re në një shoqatë të udhëhequr nga kreu i inteligjencës së Rusisë. Vulin ka marrëdhënie të ngushta me Rusinë dhe për shkak të veprimtarisë së vet është njeri i sanksionuar nga Shtetet e Bashkuara. Ministri Sveçla tha më tej të



mërkurën se Vulini e përdori një “precedent të rrezikshëm” kur tha se inteligjenca serbe “di si ta bëjë këtë, sepse e kemi bërë më parë”. Sveçla shtoi se “historia jonë e afërt dëshmon se strukturat e inteligjencës serbe kanë qenë të përfshira në vrasjen e veprimtarëve të shquar politikë shqiptarë, si Jusuf Gërvalla, Bardhosh Gërvalla dhe Kadri

Zeka”, të cilët ishin vrarë më 1982 në Gjermani. Sveçla tregoi gjithashtu se në mes të muajit të kaluar, autoritetet kosovare i arrestuan dy shtetas bjellorusë dhe një shtetas rus, të cilët, sipas tij, ishin futur në Kosovë jashtëligjshëm të kamufluar, pasi kishin qëndruar në Serbi paraprakisht. Rasti i tyre është duke u shqyr-

tuar, shtoi ai. “Përveç përvojës së tyre ushtarake, trajnimeve specialistike me eksploziv dhe lidhjeve me Serbinë, ata posedonin pajisje për orientim, kamuflim dhe realizim të planeve operative – elemente që përkrijnë me retorikën e artikuluar nga Vulin”, theksoi Sveçla. Kosova dhe Serbia vazhdojnë të kenë marrëdhënie shumë të tensionuara, posaçërisht nga viti 2023, kur një grup serbësh të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në një fshat të Zvečanit në veri të vendit, duke lënë një rreshter të vrarë. Vendi u trondit edhe nga një shpërthim një vit më vonë, kur kanali jetik i ujit, Ibër-Lepenci, u dëmtua rëndë në veri. Kosova e ka fajësuar Serbinë për të dyja incidentet, por Beogradi ka mohuar të ketë pasur gisht në to.

## Qasje e lartë e ekonomive familjare në TIK

Prishtinë, 4 mars - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Përdorimit të Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK) në Ekonomitë Familjare për vitin 2025. Sipas rezultateve të Anketës TIK në Ekonomitë Familjare, përqindja e ekonomive

familjare që kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2025 ishte rreth 99,3 %. Ndërkohë që 0,6 % e ekonomive familjare kanë deklaruar se nuk kanë pasur qasje në internet gjatë vitit 2025. Grupmosha me përqindjen më të lartë të qasjes në internet ishte grupmosha 16-24 vjeç me

rreth 20 %, pasuar nga grupmosha 25-34 vjeç me 19,2 %. Ndërkohë me përqindjen më të vogël të qasjes në internet ishte grupmosha 65-74 me rreth 10,1 %. Sipas të dhënave të Anketës TIK në Ekonomi Familjare, përdorimi i internetit nga femrat dominon me 50,1 %, krahasuar

me meshkujt që ishte 49,9 %. Sipas të dhënave të Anketës TIK në Ekonomi Familjare, prej 98,5 % të personave që e përdorin internetin në tre (3) muajt e fundit, 45,6 % e tyre i shfrytëzuan edhe mjetet gjeneruese të inteligjencës artificiale (IA) për qëllime të ndryshme private, shkollim ose profesionale.





## Kosova dhe Shqipëria zotohen për thellim të bashkëpunimit për auditime

PRISHTINË, 4 MARS - Auditorja e përgjithshme e Republikës së Kosovës, Vlora Spanca, ka pritur në takim kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSh), me bashkëpunëtorë. Në takim u vlerësua bashkëpunimi shumë i mirë ndër vite ndërmjet ZKA-së dhe KLSh-së, i ndërtuar mbi profesionalizëm, besim dhe

mbështetje të ndërsjellë. Spanca dhe Shehu u zotuan për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit profesional, me theks të veçantë në realizimin e auditimeve paralele në fushën e bujqësisë, blegtorisë si dhe të sigurisë në vend. Deri më tani janë realizuar disa auditime paralele, duke

dëshmuar gatishmërinë dhe kapacitetin e dy institucioneve për të koordinuar qasje dhe metodologji të përbashkëta. Auditorja e përgjithshme Vlora Spanca tha se bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve ka qenë i qëndrueshëm dhe përmbytësor, duke shtuar se shkëmbimi i përvojave dhe

mbështetja profesionale ndërmjet dy institucioneve ka kontribuar drejtpërdrejt në ngritjen e kapaciteteve dhe forcimin e rolit të institucioneve në shërbim të llogaridhënies publike. Po ashtu, palët theksuan lidhjen e veçantë që i bashkon si pjesë e të njëjtit komb, çka e bën bashkëpunimin jo vetëm



institucional, por edhe natyrshëm të afërt në misionin për forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë.

## KUR ENERGJIA BËHET ARMË: BOTA NË PRAG TË NJË EPOKE TË RE EKONOMIKE



Shkruan: Nazmi JUSUFI, ekspert i ekonomisë dhe financave

Ekonomia globale po hyn në një fazë dramatike transformimi, ku energjia nuk është më vetëm mall tregu, por instrument presioni, ndikimi dhe dominimi strategjik. Tensionet gjeopolitike nuk po

zhvillohen më në periferi të ekonomisë - ato po e drejtojnë atë. Në zemër të kësaj tronditjeje qëndron korridori jetik i ngushticës së Hormuzit, arteria përmes së cilës kalon një pjesë e madhe e naftës dhe gazit botëror. Çdo kërcënim për bllokimin e këtij kalimi detar përkthehet në alarm të menjëhershëm në bursat ndërkombëtare, në tregjet e energjisë dhe në politikat monetare të fuqive të mëdha. Zhvillimet rreth Iranit dhe rivalitetet me aktorë të tjerë globalë nuk janë më thjesht çështje rajonale. Ato janë bërë katalizatorë të luhatjeve financiare globale. Tregjet reagojnë para se të reagojnë

shtetet. Çmimet rriten para se të bien bombat. Inflacioni ndizet para se të ndërpriten furnizimet. Kjo është epoka e “inflacionit gjeopolitik”. Çdo rritje e çmimit të naftës përkthehet në kosto më të lartë transporti, ushqimi, prodhimi dhe energjie për familjet. Fuqia blerëse tkurret. Investimet ngadalësohen. Rritja ekonomike dobësohet. Ndërkohë, bankat qendrore përballen me një dilemë të rrezikshme: të luftojnë inflacionin me norma më të larta interesi dhe të rrezikojnë recesionin, apo të tolerojnë presionin e çmimeve për të mbrojtur rritjen. Për Unionin Evropian ky

realitet është një provë historike. Kontinenti që synon tranzicionin e gjelbër dhe autonominë strategjike përballat me një paradoks: sa më e brishtë të jetë siguria energjetike globale, aq më i madh bëhet presioni mbi ekonominë evropiane. Ballkani Perëndimor dhe Kosova ndodhen në vijën e parë të këtij presioni të heshtur. Ekonomitë e vogla janë më të ndjeshme ndaj goditjeve të çmimeve, sepse hapësira fiskale është e kufizuar dhe varësia nga importet është e lartë. Çdo krizë energjetike globale reflektohet drejtpërdrejt në faturat e qytetarëve. Por përtej krizës fshihet një

transformim më i thellë. Energjia po kthehet në monedhë gjeopolitike. Investimet në burime alternative, në energji të ripërtërishme dhe në infrastrukturë strategjike nuk janë më vetëm zgjedhje ekonomike - ato janë vendime të sigurisë kombëtare. Shtetet që arrijnë pavarësi energjetike do të kenë stabilitet politik. Ato që mbeten të varura do të përballen me cikle të përsëritura pasigurie. Bota po lëviz drejt një rendi të ri ekonomik, ku stabiliteti nuk matet vetëm me rritjen e PBB-së, por me sigurinë e furnizimit dhe kontrollin e burimeve.

## FAZA E DYTË E LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË: NGA 1 PRILLI 2026 BIZNESET KALOJNË NË TREG TË HAPUR

PRISHTINË, 4 MARS - KESCO, në cilësinë e Furnizuesit të Shërbimit Universal, ka njoftuar se në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe me kërkesë të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRE), nga data 1 prill 2026 do të vazhdojë faza e dytë e daljes së konsumatorëve komercialë në tregun e hapur.

Sipas kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi, konsumatorët komercialë që kanë mbi 50 punonjës ose realizojnë qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro nuk do të furnizohen më në kuadër të shërbimit universal me tarifa të rregulluara, por do të jenë të obliguar ta zgjedhin vetë furnizuesin e tyre. Bazuar në të dhënat zyrtare



të Administratës Tatimore të Kosovës, një numër biznesesh nuk i plotësojnë më kriteret për furnizim në kuadër të shërbimit

universal. Për këtë arsye, duke filluar nga 1 prill 2026, KESCO në rolin e Furnizuesit të Shërbimit Universal nuk do të mund t'i furnizojë këto

biznese me tarifa të rregulluara. Bizneset përkatëse duhet që deri më 1 prill 2026 të zgjedhin një furnizues të licencuar në tregun e hapur dhe të fillojnë procedurën e ndërrimit të furnizuesit të paktën 21 ditë pune para hyrjes në fuqi të kontratës së re. Lista e furnizuesve të licencuar është e publikuar në faqen zyrtare të ZRE-së. Në rast se një biznes nuk zgjedh furnizues me kohë, nga 1 prill 2026 do të furnizohet përkohësisht nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për një periudhë deri në 60 ditë, gjatë së cilës duhet të lidhë kontratë me një furnizues të licencuar. Në mungesë të një kontrate brenda këtij afati, furnizimi me energji elektrike do të

ndërpritet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bizneset që janë vet-konsumatorë (prosumatorë) njoftohen se nga kjo datë përfundon marrëveshja ekzistuese për vet-konsum në kuadër të skemës me tarifa të rregulluara, ndërsa trajtimi i energjisë së prodhuar dhe të injektuar në rrjet do të rregullohet sipas kushteve të kontratës me furnizuesin e zgjedhur. KESCO fton bizneset që të konfirmojnë pranë kompanisë numrin e punonjësve, qarkullimin vjetor dhe njësitë/matësit në shfrytëzim, në mënyrë që të sigurohet trajtimi korrekt gjatë procesit të kalimit në tregun e hapur.

## Komisioni për Buxhet miraton ndarjen e katër milionë eurove për RTK-në

PRISHTINË, 4 MARS - Komisioni për Buxhet ka miratuar planifikimin financiar të Radio Televizionit të Kosovës (RTK) për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026, në vlerë prej 4 milionë e 480 mijë eurosh nga buxheti i Kosovës, mes diskutimeve


për sfidat financiare dhe menaxhimin e institucionit. Drejtori i financave në RTK, Gazmend Rexhepi, tha se për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026 RTK ka të parapara 4 milionë e 480 mijë euro nga buxheti i Kosovës. Ushtruesi i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të

RTK-së, Hysen Hundozi, ka deklaruar se viti 2025 ka qenë sfidues për shkak të mosfunksionalitetit të bordit dhe Kuvendit si themelues, duke theksuar se RTK-ja është përballur me rrezik për mospagesë të pagave për herë të parë në historinë e saj.





# OPERACIONI “ARGO”: SI I NXORI CIA AMERIKANËT NGA TEHERANI, ME NJË SKENAR SI NË FILMA



Në dimrin e vitit 1979, Teherani ishte kthyer në qendrën e një krize që mbante gjithë botën në ankth. Revolucionari islamik kishte rrëzuar monarkinë dhe marrëdhëniet mes Iranit dhe Shteteve të Bashkuara ishin në pikën më të ulët të historisë së tyre. Kur studentë revolucionarë pushtuan ambasadën amerikane dhe morën peng diplomatët, kriza u shndërrua menjëherë në një përballje dramatike mes dy botëve, një dramë që do të zgjaste plot 444 ditë.

Por ndërsa kamerat e botës ishin të drejtuara tek pengjet dhe negociatat diplomatike, në prapaskenë po përgatitej një plan i pabesueshëm. Një operacion i CIA-s që do të përdorte identitete të rreme, një kompani fantazmë filmash në Hollywood dhe një histori të sajuar për një film fantastiko-shkencor, për të nxjerrë fshehurazi amerikanët nga Irani.

## Operacioni “Argo”, sfida e jashtëzakonshme e CIA-s

Operacioni do të hynte në histori si “Argo”, një nga misionet më të guximshme dhe më të pazakonta të spiunazhit modern, ku kufiri mes realitetit dhe një skenari filmi u bë pothuajse i padallueshëm.

4 Nëntori 1979 nisi si çdo ditë tjetër në Ambasadën e SHBA në Teheran. Staf i fut brenda në orarin e zakonshëm, ndërkohë që marinsat zunë vendet e tyre në pozicione. Turma e përditshme e protestuesve anti-amerikanë u mblodh jashtë dyerve të ambasadës duke thirrur “Allahu akbar! Marg bar Amrika!”

Mark dhe Cora Lijek, një çift i ri në moshë që e kishin për herë të parë që punonin në shërbimin e jashtëm, i dinin sloganët, “Zoti është i Madh! Vdekje Amerikës!”, dhe ishin mësuar ta injoronin poteren jashtë dhe të vazhdonin punët e përditshme. Por sot, protesta tingëllonte më e zhurmshe se zakonisht. Dhe kur disa prej punonjësve vendas erdhën dhe thanë se “kishte një problem tek porta”, ata e kuptuan menjëherë se ky mëngjes do të ishte ndryshe. Studentë militantë, pas vetëm pak çastesh po i ngjiteshin shkallëve të kompleksit të ambasadës. Dikush hapi me forcë portën ballore, dhe rryma me njerëz që kishin mundur të depërtonin u shndërrua shumë shpejt në një “përmbytje”.

Turma u përhap me shpejtësi nëpër kompleks, duke tundur në ajër postera të Ajatollah Khomeinit. Ata pushtuan rezidencën e ambasadorit, më pas u nisën drejt arkivit, fortës e ambasadës ku ishte vendosur pjesa më e madhe e stafit.

## Si u pushtua ambasada amerikane në Iran në vitin 1979

Në fillim, Lijeks-i shpresoi se ndërtesa e konsullatës ku ata ndodheshin nuk do të vihej re. Për shkak të riparimeve të kryera kohët e fundit, kati përdhes ishte pothuajse bosh. Ndoshta askush nuk do të dyshonte që 12 amerikanë, disa punonjës iranianë si dhe ata që aplikonin për viza ndodheshin në katin e sipërm. Grupi përfshinte konsullin Joseph Stafford, asistenten dhe bashkëshorten e

tij, Kathleen dhe Robert Anders, një zyrtar i lartë në departamentin e vizave. Ata u përpoqën të ruajnë qetësinë, madje edhe të vazhdojnë punën. Por, pas pak u ndërpre energjia elektrike dhe paniku nisi të përhapej me shpejtësi në ndërtesë. Punonjësit iranianë, që e njihnin mirë prirjen e forcave revolucionare iraniane për të shtënë, u bënë gati për më të keqen. “Dikush ka hipur mbi çati”, tha një punonjëse iraniane, duke u dridhur. Një tjetër nuhati tym. Njerëzit nisën të qajnë në errësirë, të bindur se militantët do t'i vinin flakën ndërtesës. Jashtë, të thirrurat e turmës u bënë më të forta. Tek-tuk, dëgjoheshin të shtëna. Ishte koha për të ikur.

Amerikanët shkatërruan lastrat që përdoreshin për të bërë vulat e vizave, organizuan një plan evakuimi dhe u kërkuar të gjithëve të shkonin tek dera e pasme. “Do të largohemi në grupe prej pesë apo gjashtë vetësh”, tha kryemarinisi që ndodhej atë ditë në detyrë. “Në fillim vendasit. Pastaj çiftet e martuara. Më tej, pjesa tjetër”. Ndërtesa e konsullatës ishte e vetmja strukturë në kompleks me dalje në rrugë. Qëllimi ishte të arrihej deri në ambasadën britanike, e cila ndodhej gjashtë blloqe banimi më tutje.

Binte një shi i dendur kur ata hapën dyert e rënda prej çeliku. Rruga ishte e boshatisur. Një grup u nis drejt veriut, por pak çaste më vonë u kap dhe u detyrua të kthehet mbrapsht në ambasadë, nën kërcënimin e tytave të armëve.

Duke ecur drejt perëndimit, Staffordët, Lijeksët, Andersët dhe

disa iranianë arritën të mos pikaseshin. Pothuajse kishin mbërritur në ambasadën britanike kur ndeshën në një tjetër demonstratë. Një vendas që ish pjesë e grupit të tyre u dha një këshillë të atypëratyshme: “mos shkoni andej”. Dhe pastaj u zhduk brenda turmës. Grupi u shmang duke bërë disa zig-zage drejt apartamentit të Andersëve që ndodhej aty pranë, duke kaluar madje një moment shumë pranë zyrave që përdoreshin nga komiteti, bandat e armatosura të revolucionarëve, që kontrollonin një pjesë të madhe të Teheranit.

## Diplomatët amerikanë të bllokuar në zemër të revolucionit iranian

Mbyllën derën me kyç dhe ndezën radion e Andersëve, një pajisje standarte që mund të lidhej me rrjetin e radiondërlidhjes të ambasadës. Marinsat thërrisnin si të marrë, në përpjekje për t'u koordinuar me njëri-tjetrin. Dikush që identifikohet me emrin e koduar “Palm Tree” thoshte se “shumë pushkë dhe armë janë duke u futur në kompleks”. Ky ishte Henry Lee Schatz, një atashe i bujqësisë që po e shihte skenën nga zyra e katit të gjashtë në ndërtesën përballë kompleksit të ambasadës. “Po shkarkojnë nga kamionët”.

Kishte nisur kriza e pengjeve në Iran. Ajo do të zgjaste 444 ditë, do të trondiste vetëbesimin e Amerikës, si dhe do të fundoste një herë e mirë fushatën e rizgjedhjes së presidentit Jimmy Carter. Amerikanëve nuk do u ndaheshin nga sytë fytyra e ngrysur e Khomeinit, si dhe

militantët e armatosur islamikë që parakalonin pengjet me sytë lidhur nëpër lajmet e natës, si dhe kërcënonin me gjyqe për “spiunët” që kishin kapur. Të gjithë kujtojnë 52 amerikanët e zënë brenda ambasadës dhe përpjekjen e dështuar për shpëtimin e tyre disa muaj më vonë, e cila përfundoi me rrëzimin e një helikopteri amerikan në shkretëtirën iraniane.

Por jo shumë vetë i njohin detajet, që kanë qenë të klasifikuara për një kohë të gjatë, të angazhimit të CIA-s në arratisjen e grupit tjetër, i cili kishte ngecur në një qytet armiqësor nën kthetrat e revolucionit.

Deri në orën 3 të pasdrekës së asaj dite, 5 personat e strehuar në apartamentin me një dhomë të Andersëve e kishin kuptuar tashmë se ishin në një telash të madh. Ndërkohë që militantët merrnin kontrollin, kishte gjithnjë e më pak anglishtfolës në rrjetin e radiondërlidhjes. Emri i koduar “Palm Tree” kishte ikur. Pasi të fundmit në ndërtesën e arkivit informuan në radio se po dorëzoheshin, të vetmit zëra që dëgjoheshin tani prej kutisë së radios flisnin gjuhën Farsi. Ambasada ishte humbur. Të arratisurit ishin vetëm.

## Ndërkohë në zyrat qendrore të CIA-s

CIA ishte në kaos kur Tony Mendez erdhi e u ul në vendin e tij të punës mëngjesin tjetër. Njerëz rendnin nëpër korridore, me dosje dhe dokumenta në duar. Tryezat po mbusheshin me kabllogramë “të shpejtë”,



mesazhet me prioritet më të lartë, që rezervoheshin vetëm për situata luftarë.

Mendez-i, 38 vjeç, kishte qenë në agjenci gjatë Luftës së Vietnamit. Por situata sot dukej më e rëndë. Të paktën atëherë SHBA e kishte një tjetër qeveri me të cilën të bisedonte. Në Iran, Ajatollah Khomeini dhe Këshilli Revolucionar refuzonin të negocionin. Pa kanale të hapura diplomatike, pjesa më e madhe e infrastrukturës së informacionit të CIA në Teheran ishte shkatërruar. Si ish kreu i Sektorit të Maskimit, dhe kreu aktual i Divizionit të Grafikës dhe Verifikimit në CIA, Mendezi mbikëqyrte operacionet logjistike që kryente CIA, me dhjetëra-mijëra identitete false. Ai e dinte se kishte vetëm tre agjentë të terrenit në Iran dhe të gjithë ata ishin pengje në ambasadë.

Në fillim, Mendezi mendoi se detyra e tij ishte të lironte pengjet. Filloi të përgatisë agjentë për të penetruar në Iran, dhe 90 orët e ardhshme i kaloi pa bërë pushim duke përgatitur një plan të quajtur “Operacioni Truproja”, sipas të cilit një kufomë, sozi e Shahut të Iranit do të përdorej për të siguruar lirin e pengjeve. Ishte një plan i mrekullueshëm, mendoi. Por Shtëpia e Bardhë e hodhi poshtë. Disa javë pas pushtimit të ambasadës, Mendezi mori një Memorandum me shenjë “top secret” mbi të, nga Departamenti i Shtetit. Lajmi ishte befasues: Jo të gjithë ata që ndodheshin brenda ambasadës ishin kapur. Disa kishin mundur të largoheshin dhe qëndronin fshehur diku në Teheran. Vetëm një grusht zyrtarësh i dinin detajet, sepse këshilltarët e Jimmy Carterit dhe Departamenti i Shtetit nuk donin që ta merrnin vesh iranienët.

Mendezi kishte kaluar 14 vite në Zyrën e Shërbimit Teknik të CIA-s, ajo pjesë e agjencisë së spiunazhit, që është bërë e njohur për planet e vendosjes së eksplozivëve brenda purove të Fidel Castros, apo planet për vendosjen e mikrofonëve brenda

trupit të maceve për të përgjuar. Specialiteti i tij ishte përdorimi i “transformimit të identitetit” për të nxjerrë njerëzit nga situata të vështira.

Një herë ai kishte transformuar një oficer me ngjyrë të CIA-s dhe një diplomat aziatik në biznesmenë kaukazanë, me qëllim që ata të siguronin një takim në kryeqytetin e Laosit, një vend ku mbizotëronte gjendja e jashtëzakonshme. Kur një inxhinier rus duhej të dorëzonte kuti me filma që përmbanin detaje shumë sensitive mbi avionin e ri super-MiG, Mendezi ndihmoi agjentët e CIA-s që të hiqnin qafe spiunët e KGB. Një oficer do të priste për një moment pështjellimi, që të dilte tinëz nga makina. Sapo ai të dilte, një manekin me sustë do të ngrihej menjëherë për të krijuar përshtypjen se ai ndodhej ende në sediljen e pasagjerit. Mendez-i kishte shpëtuar qindra agjentë që të largoheshin pa u vënë re.

### Një plan i pazakontë merr formë në CIA

Për operacionin në Teheran, strategjia e tij ishte e drejtpërdrejtë: Amerikanët do të pajiseshin me identitete false, do të dilnin menjëherë përmes Aeroportit Mehrabad dhe do të hipnin në një avion. Sigurisht, që ky plan të funksiononte, dikush duhej të futej ë Iran, të lidhej me të arratisurit, t’u jepte pasaportat false dhe t’i udhëhiqte drejt daljes, nëpër aparatir iranien të sigurisë. Dhe ky “dikushi” ishte ai vetë.

Ndërkohë në Teheran, të larguarit nga ambasada ishin tashmë në shënjestër. Ata nuk mund të dilnin vetëm, pasi do të pikaseshin në rrugë dhe me siguri do të merreshin në pyetje në aeroport. Nëse paraqisnin pasaporta diplomatike, do i kthenin me nxitim në ambasadë dhe aty do të merreshin në pyetje me armët te koka, bashkë me “spiunët” e tjerë.

Gjatë ditëve të para, ata transferoheshin fshehtas në vende të ndryshme, përfshirë shtëpitë e boshatisura të atyre që



ishin tashmë pengje në ambasadë. Shpesh herë flinin siç ishin, me rroba, në rast se u duhej të largoheshin nxitimthi. Përdorimi i një telefoni ishte me rrezik: imamët përgjonin tashmë nëpërmjet rrjetit të madh të përgjimeve që shahu kishte përdorur dikur për të shtypur kundërshtarët. Një moment, Anders i telefonoi John Sheardownit, një miku i tij në ambasadën kanadeze. “Përse nuk ke telefonuar më parë”, iu përgjigj Sheardowni. “Sigurisht që mund të vini”.

Për të minimizuar rrezikun, grupi ishte shpërndarë mes shtëpisë së Sheardownit, dhe rezidencës zyrtare të ambasadorit kanadez, Ken Taylor. Të dy shtëpitë ndodheshin në lagjen Shemiran në veri të Teheranit. Dinastia Kajar kishte varrosur mbretërit e saj këtu, në kodrinat rrëzë maleve Elburz, dhe tani kjo lagje goxha në modë ishte e banuar nga tregtarë, diplomatë, nëpunës civilë të pasur, si dhe disa refugjatë diplomatikë në fshehje: të pestët nga konsullata dhe Henry Lee Schatzi, personi që fliste në radio me emrin e koduar “Palm Tree”. Ai ishte fshehur në një rezidencë diplomatike suedeze për disa javë, përpara se të shkonte në shtëpinë e Sheardownëve.



Vendstrehimi ishte në kushte luksi. Kishte libra, gazeta në anglisht dhe shumë birrë, verë dhe uiski. Por mysafirët nuk mund të largoheshin asnjëherë nga banesa. Me kalimin e javëve, u krijua një rutinë e qetë. Ata gatuanin për darkat e bollshme, lexonin dhe luanin me letra. Shqetësimi më i madh i çdo dite ishte si të bënin bashkë skuadrat për të luajtur “bridge”, dhe nëse do të kapeshin dhe ndoshta ekzekutoheshin.

Teksa koha kalonte, rreziku i zbulimit sa vinte e rritej. Militantët kishin krehur të dhënat e ambasadës dhe kishin zbuluar se cilët i përkisnin CIA-s. Ata kishin punësuar madje edhe skuadra tapetpunuesish, që do të jepnin një dorë për të ngjitur dokumentat e grisur. (Dokumentat e gjetur do të botoheshin më pas nga qeveria iraniane në një seri librash me titull “Dokumenta nga strolulla amerikane e spiunazhit). Ata mund të mësonin me kalimin e kohës numrin e vërtetë të stafit të ambasadës, të numëronin, dhe të kuptonin se disa mungonin. Jashtë, Garda Revolucionare ishte shfaqur disa herë në Shemiran, duke u hakërryer në rrugët ku jetonin të huajt dhe duke iu afruar shumë të dy vendstrehimeve. Një herë, amerikanëve iu desh të largoheshin nga dritaret, kur një helikopter ushtarak i erdhi rrotull shtëpisë së Sheardownëve. Dhe të gjithë u trembën kur një telefonues anonim në rezidencën e Taylorit, kërkoi të fliste me Jope dhe Kathy Stafford, dhe më pas e uli receptorin.

### Nervozizmi deri në gjetjen e zgjidhjes

Qeveritë e SHBA dhe Kanadasë ishin edhe ato nervoze. Informacionet për të arratisurit nga ambasada kishin rrjedhur dhe shumë gazetarë ishin në prag të nxjerrjes së lajmit. Edhe teksa CIA punonte për të liruar të gjashtë, u shfaqën një seri planesh shpëtimi, që përfshinin kryesisht hyrjen nëpërmjet kufirit apo kontrabandistët. CIA

zhvilloi bisedime me Ross Perot, i cili sapo kishte nxjerrë në fshehtësi dy prej punonjësve të tij të “Electronic Data Systems” nga qelitë në Teheran. Gjatë një takimi të NATO-s në dhjetor, Flora MacDonald, ministria e jashtme kanadeze i tha Sekretarit amerikan të Shtetit, Cyrus Vance, që të gjashtë amerikanët duhej të nxirreshin nga kufiri turk, qoftë edhe me biçikleta.

Amerikanët e ndjenë që rreziku sa vinte e rritej. Në 10 janar 1980, pothuajse nëntë javë pas ngjarjes në ambasadë, Mark Lijeku dhe Andersi hartuan një kabllogram për Ken Taylorin, që ta dërgonte në Uashington në emër të tyre. Më vonë, Marku e përblodhi kështu përmbajtjen e tij: “Ne duhet të dalim patjetër prej këtu”.

Planet e CIA-s zakonisht projektohen që të jenë sa më të zakonshme dhe të mos tërheqin vëmendje. Pikërisht kështu nisi edhe plani i Mendezit. Ai do të përdorte dokumenta kanadeze për amerikanët, për shkak të gjuhës së përbashkët dhe kulturës së ngjashme. Në fund të fundit, të gjithë i duan kanadezët. Por Mendezit i duhej sërish që të gjente një arsye për gjashtë kanadezët që vërdalloseshin mu në mes të trazirave të Teheranit. Kishte shumë gazetarë amerikano-veriorë, punonjës humanitarë dhe këshilltarë të industrisë së naftës në vend. Por ata ishin ose të monitoruar gjatë të gjithë kohës, ose të njohur mirë prej autoriteteve.

Departamenti i Shtetit mendoi që ata do të maskoheshin si mësues të papunë, deri kur dikush tha se shkollat anglishtfolëse në vend ishin mbyllur. Kur qeveria kanadeze sugjeroi që të maskoheshin si bujq që inspektonin të korrat, Mendezi e hodhi poshtë idenë si qesharake: “A keni qenë në Teheran në janar? Toka është e mbuluar nga dëbora. Dhe nuk ka bujqësi”.

Plani kishte ngecur. Për pothuajse një javë, askush në Uashington apo në Otava nuk mund të sajonte një arsye për çdokënd që të ndodhej në



Teheran. Pastaj, Mendezit i shkrep i në kokë një plan i pazakontë, por çuditërisht i besueshëm: ai do të shndërrohej në Kevin Costa Harkinsin, një producent filmash irlandez i cili udhëhiqte grupin e tij të xhirimit në Iran, për të gjetur një vend për xhirimin e një filmi të madh epik të Hollivudit. Mendezi kishte kontakte në Hollivud nga bashkëpunimet e mëparshme. (Në fund të fundit, ishin të gjithë në biznesin e krijimit të identiteteve false). Dhe nuk do të ishte e habitshme, mendoi Mendezi, që një grup njerëzish të çuditshëm nga Tinseltauni të ishin të pavëmendshëm ndaj situatës politike në Iranin revolucionar. Qeveria iraniane po përpiquej të inkurajonte biznesin ndërkombëtar që të afrohej. Ata kishin nevojë për para të thata, dhe një produksion filmi mund të përkthehej në miliona dollarë.

Agjenti i CIA-s ofron një plan veprimi

Mendezi u dha eprorëve një plan veprimi, me një analizë të qëllimit, misionit dhe logjistikës. Detyra ishte kaq e vështirë saqë shifat e tij kishin thënë që do të miratonin vetëm një superplan të menduar mirë. Por ky propozim ishte mjaftueshëm i detajuar për t’u aprovuar prej tyre dhe prej Shtëpisë së Bardhë. Për të ndërtuar sa më mirë skemën e maskimit, Mendezi mori një valixhe me 10 mijë dollarë dhe u nis për në Los Angeles. I telefonoi mikut të tij, John Chambersit, një artist veteran i makijazhit, i cili në vitin 1969 kish fituar një çmim “Academy Awards” për filmin “Planeti i majmunëve” dhe njëkohësisht një prej bashkëpunëtorëve më të vjetër të Mendezit. Chambersi mori me vete një specialist të efekteve speciale, Bob Sidellin. Ata u takuan në mes të janarit dhe Mendezi i informoi për situatën dhe skemën e tij. Chambersi dhe Sidelli menduan për pengjet që shihnin çdo ditë në lajme në televizor dhe pranuan menjëherë. Mendezi e dinte që duhej të planifikonin deri në hollësinë më të vogël. “Nëse dikush kontrollon”, tha ai, “duhet patjetër që të kemi hedhur themelin”. Nëse zbuloheshin, mund të fusnin në telash qeverinë, të kompromentonin agjencinë dhe të vinin në rrezik jetët e tyre, si dhe ato të pengjeve në ambasadë. Militantët e kishin thënë që në fillim se çdo përpjekje për t’i shpëtuar do të shkaktonte ekzekutime. Brenda vetëm katër ditëve, Mendezi, Chambersi dhe Sidelli krijuan një kompani produksioni false në Hollivud. Ata sajuan kartëvizita dhe shpikën identitete për të gjashtët. Zyrat e kompanisë së produksionit do të ishin në një suitë të Studiove “Sunset Gower”, në një vend që ishte lënë bosh

prej Michael Douglasit, pasi kishte përfunduar xhirimet e filmit “Sindroma e Kinës”.

Në lojë hyn Hollivudi

Tani u nevojitej një film. Chambersi kishte skenarin e përsosur. Disa muaj më herët, atij i kishte telefonuar një aspirant për producent me emrin Barry Geller. Gelleri kish blerë të drejtat për romanin shkencor të Roger Zelaznyt, “Zoti i Dritës”, e kishte përshtatur, kishte mbledhur disa miliona dollarë si kapital fillestar nga investitorë të pasur, dhe kishte punësuar Jack Kirbyn, artistin e famshëm të librave me figura për të realizuar vizatimet që përmbanin konceptin e filmit. Gjatë gjithë kohës, Gelleri kishte imagjinuar një park në Kolorado që do të quhej “Science Fiction Land”. Do të kishte shumë robotë. Gelleri e kishte shpallur planin e tij të madh në nëntor gjatë një konference për shtyp ku kishte marrë pjesë edhe Jack Kirby, ish ylli i futbollit amerikan Rosey Grier, që parashikohej të luante në film, si dhe disa persona që ishin veshur si vizitorë nga e ardhmja. Pak kohë më vonë, zëvendësi i Gellerit ishte arrestuar për përvetësim të fondeve të produksionit, dhe kështu avulloi edhe projekti i filmit “Zoti i Dritës”. Duke qenë se Chambersi ishte punësuar prej Gellerit për të kryer gjithë pjesën e makijazhit në film, ai kishte ende skenarin dhe vizatimet në shtëpinë e tij. Ngjarjet e filmit ndodhnin në një planet të kolonizuar. Kishte vende në Iran që ofronin sfondin e përsosur për shumë nga skenat e parashikuara në plan. Një Pazar i famshëm në Teheran ishte i përsosur për një prej skenave. “Eshtë perfekte”, tha Mendezi. Ai grisi kapakun dhe i vuri një emër të ri, Argo, si anija e përdorur nga Jasoni gjatë udhëtimit të tij të guximshëm nëpër botë, për të rigjetur Cohën e Artë. Kompania e re e produksionit e pajisi zyrën me linja telefonike, makina shkrimi, postera filmash dhe kuti, si dhe një shenjë tek dera: “Studio Six Productions”. Sidelli lexoi skenarin dhe hartoi një plan për një muaj xhirime. Mendezi dhe Chambersi krijuan një reklamë një faqe për filmin dhe paguan një faqe tek “Variety” dhe “The Hollywood Reporter”. Një natë para se Mendezi të kthehej në Uashington, “Studio Six” organizoi një festë ku ngritën dollin për “produksionin” e tyre. Menjëherë pas kësaj, reklamati e filmit Argo u shfaqën në revista, bashkë me shpalljen se xhirimet do të nisnin në mars. Titulli i filmit ishte shkruajtur me gërma të forta, në një sfond të zi. Në krah ishte një vrimë plumbi. Më poshtë, ishte shkruajtur “Një zjarr i madh kozmik”. Mendezi u fut në Iran në 25 janar 1980, pasi mori një telegram nga drejtori i CIA-s që i përcillte miratimin personal të presidentit Carter, ku shkruhej “Mund të vazhdoni. Paçi fat!” Ai fluturoi



nga Europa, ku kishte siguruar një vizë në konsullatën iraniane në Bon. “Kam një takim biznesi me ortakët e kompanisë sime”, u shpjegoi ai autoriteteve iraniane në Gjermani. “Ata do të fluturojnë nga Hong Kongu nesër dhe po më presin”. Mendezit i kishin shpërthyer djersë të ftohta në aeroport (edhe profesionistët kanë momentet e tyre të dobësisë), por e dinte që në këtë pikë, nuk kishte kthim pas. Besonte shumë në forcën e historisë që kishte sajuar.

Identitetet e rreme dhe përgatitja e operacionit

Si specialist në falsifikime, Mendezi mbërriti bashkë me pajisjet e tij të bojërave të ujit. Por pjesa tjetër e mjeteve që do të nevojiteshin ishin dërguar më parë nëpërmjet rrugëve diplomatike dhe e prisnin në ambasadën kanadeze. Mendezi përfshiu gjithçka që mund të nevojitej: karta të kujdesit shëndetësor dhe patenta shoferësh, fatura nga restorante në Toronto dhe Montreal, kartëvizitat e “Studio Six”, një aparat për kinematografin, si dhe materialet e produksionit të Argos-it. Gjashtë pasaportat ishin ajo çfarë Mendezi e quante “falso të vërteta”: dokumenta që qeveria kanadeze kishte përgatitur, të porositura nga CIA. Marrja e atyre pasaportave kish qenë një goditje e befasishme në fakt. Ligjet kanadezë e ndalojnë një falsifikim të tillë, por parlamenti i këtij vendi ishte mbledhur në një seancë të fshehtë, e para që nga Lufta e Dytë Botërore, për të bërë një përjashtim. Mendezi u takua me ambasadorin Ken Taylor në zyrën e tij, mori pasaportat kanadeze dhe u vendosi atyre viza iraniane. Pjata e bojës i ishte tharë prej udhëtimit, por ai e lagu me pak uiski nga i ambasadorit dhe vendosi me kujdes datat që tregonin se gjashtë pjesëtarët e produksionit kishin mbërritur në Iran një ditë më parë. Atë natë, Staffordët, Lijeksët, Schatzët dhe Andersët darkuan me ambasadorët e Danimarkës

dhe Zelandës së Re, bashkë me një pjesë të stafit, në rezidencën e Sheardownit. Amerikanët kishin ndezur zjarrin dhe po pinin, kur Taylori mbërriti bashkë me një mysafir surprizë.

Misioni top secret në Teheran

“Ne jemi përgatitur për arratinë juaj”, u tha Mendezi gjatë darkës. Më tej, ai u shpjegoi historinë e maskimit dhe u paraqiti vizatimet e Kirbyt, skenarin, reklamën në revistën “Variety” si dhe numrin e telefonit të “Studio Six” në Sunset Boulevard. Mendezi u dorëzoi kartëvizitat dhe pasaportat. Cora Lijek do të shndërrohej në Teresa Harris, shkrimtare. Marku ishte koordinatori i transportit. Kathy Staffordi ishte stilistja. Joe Staffordi ishte një ndihmës-producent. Andersi ishte drejtori. Schatzi, kameramani, mori kamerën si dhe udhëzimet, se si të përdorte një kamera tip Panaflex. Mark Lijeku vërejti se Mendezi mbante veshur një xhakjetë sportive “British Harris”, duke i qëndruar pra besnik identitetit të tij si një producent irlandez filmash.

“Po kontrollat në aeroport?”, pyeti Joe Stafford.

Ishte një pyetje me vend. Mendezi e dinte që nuk kishte operacione pa pika të dobëta dhe ky mund të ngecte diku. Autoritetet iraniane të imigrimit përdornin një kopje të dyfishtë të formularit të mbërritjes/largimit. Ishin dy fletë, njëra e verdhë, tjetra e bardhë. Sapo hyje në Iran, zyra e imigrimit mbante kopjen e bardhë, e cila duhej të krahasohej me kopjen e verdhë kur dikush largohej. Një kontakt i CIA-s në aeroportin Mehrabadit kishte siguruar formularët, dhe Mendezi nuk e kish patur aspak problem të falsifikonte kopjet e verdha. Informacionet më të fundit tregonin se agjentët e zyrës së imigrimit as nuk e merrnin mundimin që të krahasonin dy formularët. Amerikanët në fillim ishin nervozë për planin. “Më lejoni

t’ju tregoj se si funksionon ky lloj operacioni”, tha Mendezi, duke marrë dy tapa nga shishet e shumta të verës që po konsumoheshin. I vendosi midis dy gishtave të mëdhenj në dy forma D-je që bashkoheshin. “Këta janë të këqinjët”, tha ai, duke treguar që nuk mund të ndaheshin, “dhe këta jemi ne”. Me një lëvizje të shpejtë të dorës, i ndau. Çuditërisht, kjo i qetësoi. Të gjashtët ndienë se kishin një udhëheqës kompetent. “Qaq e lehtë do të jetë”, tha Mendezi, duke nuhatur rritjen e besimit tek të pranishmit. “Do t’ua hedhim”. Në Amerikë, edhe “Studio Six” ishte e zënë me punë. Bob Sidelli dhe bashkëshortja e tij, Andi, po plotësonin me staf zyrat e produksionit. Kishin tre linja telefonike. Njëri ishte një numër jo i bërë publik që e dinte vetëm CIA. Nëse ajo zile do të binte, kjo do të thoshte se Mendezi dhe pjesa tjetër e stafit të ARGO ose ishin në telash të madh, ose kishin mbërritur në shtëpi, të lirë. Andi u përgjigjej dy telefonave të tjerë, të cilët binin vazhdimisht.

Argo, filmi që u bë operacion spiunazhi

Kur u shfaqën reklamati, gazetarët e “Hollywood Reporter” dhe “Variety” nisën të telefononin, duke shkruajtur artikuj të vegjël në secilën gazetë. “Dy artistë të njohur të makijazhit në Hollivud, thoshte një prej lajmeve, janë bërë producentë”. “Filmi i tyre i parë quhet Argo, një film fantastiko-shkencor, me skenar të Teresa Harris. Filmimet do të fillojnë në jug të Francës dhe më pas do të zhvendosen në Lindjen e Mesme... në varësi të klimës politike”. Mbulimi mediatik shkaktoi menjëherë shumë interes për këtë film të Hollivudit, që do të kryente xhirimet në Lindjen e Mesme. Sidelli që kishte punuar për 25 vite në Hollivud kishte thënë gjithmonë se i gjithë qyteti vihej në lëvizje prej “broçkullave”, por edhe ai vetë ishte i befasuar se sa me lehtësi universi i sajuar i “Studio Six” dominonte tani mbi realitetin. Nuk kaloi shumë kohë



dhe kjo zyrë e CIA-s e gjeti veten të zhytur thellë në biznesin e kinematografisë. Ata ishin gjithnjë në ankth se mos dëgjonin të binte zilja e telefonit të tretë, por çdo telefonatë deri tani kish lidhje vetëm me filmin. Miqtë panë emrin e Sidellit në reklama dhe nisën ta pyesin për punën. “A e ke gati një ekip?” donin të dinin. “Kur fillon paraproduksioni?” Brenda pak javësh, “Studio Six” u mbush me skenarë dhe kërkesa producentësh. “Nuk do të xhirojmë edhe për disa muaj”, u thoshte ai. “Flasim prapë pas disa javësh”. Shumë njerëz u paraqitën tek “Studio Six” me projekte në dukje të mirë, kështu që Sidelli organizoi disa takime me ta. Një shkrimtar donte të përshtaste një tregim horror të Artur Conan Doyle, që bënte fjalë për një mumje të ringjallur. Sidelli u interesua madje për informacione nga vepra e Doyle, duke e ditur gjithësesi që, një ditë, “Studio Six” do të zhdukej nga qarkullimi.

### Dita e madhe e lirimit

Të gjithë ishin të veshur me kostume në mëngjesin e 28 janarit 1980. Cora Lijeku i rregulloi flokët dhe mori një pamje si Shirley Temple. Iu fut edhe një herë skenarit, teksa rrinin në pritje. Kathy Staffordi vuri syze të mëdha, tip boheme, i kapi flokët dhe mori të mbante në duar një dosje me vizatimet e Kirbyt. Mjekrrën e verdhë të Mark Lijekut e kishin lyer me bojë të zezë. Andersi e mendoi arratinë e tyre si një aventurë dhe u zhyt i tëri në rolin e regjisorit pompoz: Doli me një këmishë dy numra më të vogël, të kopsitur deri në gjysmën e gjoksit leshator për të nxjerrë në pah një medaljon të argjentë, gjysmë të improvizuar. Vuri syze dielli, i krehu flokët prapa veshëve dhe veprimet nisi ti bëjë pak si femërore. Gjatë dy ditëve të fundit, ata kishin bërë shumë prova. Një prej pjesëtarëve të ambasadës që njihje gjuhën farsi vishej me uniformë dhe bënte

gjoja sikur i merrte në pyetje, në kërkim të të çarave në historinë e tyre të maskimit. Kishin mësuar historinë e filmit dhe atë të personazheve dhe tani ishin në pritje për t’u nisur. Deri në orën 4 të mëngjesit kishin bërë gati gjithçka, falënderuan të zotët e “shtëpisë” dhe u nisën drejt aeroportit të Mehrabadit. Në makinë, Cora kontrolloi edhe një herë xhepat për t’u siguruar që nuk kishte asgjë që do të zbulonte emrin e saj të vërtetë. Ajo dhe të tjerët nisën të futen në rolin e ri, edhe gjatë komunikimit me njëri-tjetrin. I vetmi përjashtim ishte Joe Staffordi, i cili e kishte me mëdyshje që të linte kolegët pas në ambasadë. Nuk ishte aspak entuziast për planin dhe kishte refuzuar të ndryshonte pamjen. Dhe më e keqja, ai dukej që ishte nervoz. Mendezi ishte nisur para tyre. Zyra e tij kishte testuar Mehrabadin, kishte dërguar agentë të hynin dhe dilnin nga vendi, duke kontrolluar sigurinë atje. Por ai preferonte t’i shihte gjërat me sytë e tij. Ashtu si një grabitës bankash që “mat me sy” prenë e radhës, Mendezi do ta kuptonte menjëherë nëse gjërat ishin në rregull. Ai do të vlerësonte zyrat e doganës dhe të imigrimit, për shembull, sa i kujdesshëm ishte stafi? Më shqetësues se sa profesionistët ishin ata të komitehut dhe Gardës Revolucionare që qëndronin pas tyre. Të armatosur dhe të paparashikueshëm, ata e bënë aeroportin me të vërtetë të rrezikshëm. Por ai mëngjes dukej i qetë. Kishte pjesëtarë të komitehut tek dogana, por vëmendja e tyre ishte e përqëndruar tek vendasit që përpiqeshin të nxirrnin sixhade dhe flori kontrabandë jashtë vendit. Mendezi kishte zgjedhur mëngjesin herët për arsye se deri në orën 10, Mehrabadi do të shndërrohej në një nyje tipike të rrëmujshme tranziti, me radhë të çrregullta njerëzish që thërrisnin dhe shtyheshin. Në këtë moment do të shfaqej Garda Revolucionare për të vënë rregull.



Kur Mendezi vuri re se kishte pak prani ushtarake, ai sinjalizoi të tjerët që të viheshin në lëvizje. Gjithë ankth, amerikanët hynë në aeroport. Kishte 80 ditë që nuk kishin dalë në vende publike. Shumica e të arratisurve kishin punuar në konsullatë, dhe të gjithë e dinin se çfarë do të thoshte të kontrolloje me kujdes dokumenta, në kërkim të të metave. Tre prej tyre kishin punuar në zyrën e vizave. Që do të thotë se i kishin parë me mijëra iraniane, shumë prej të cilëve kishin ndierë zemërim kur u ishte refuzuar viza. Të gjithë morën frymë lirisht kur kontrolli tek sportelet e Swissair kaloi pa probleme. Grupi fliste shumë pak teksa Schatzi iu afrua zyrës së imigrimit, paraqiti pasaportën dhe mori vulën. Amerikanët u ndienë të tmerruar kur oficeri u largua bashkë me pasaportat e pjesës tjetër të grupit. Por ai, pa e patur hiç mendjen, u kthye prapë në vendin e tij me një gotë çaj në dorë dhe i bëri me shenjë grupit të shkonin tek salla e nisjes, pa e vrarë shumë mendjen për formularët e verdhë e të bardhë. Pritja ishte sflitëse. Të gjithë e mbanin kokën poshtë. Joe Staffordi mori një gazetë vendase, por në një moment u

kujtua se një kanadez që merrej me filma nuk mund ta dinte gjuhën. Gjithashtu, ai vazhdoi të thërrasë të tjerët me emrat e tyre realë, duke u shkaktuar të dridhura. Po bëhej vonë. Aeroporti po mbushej me njerëz. Ata e dinin që nuk kishin një plan rezervë. Mendezi nuk mbante as armë, dhe Garda Revolucionare ishte duke ardhur, duke u vërdallosur nëpër aeroport dhe duke ngacmuar njerëzit. Shikojini në sy, i kishte porositur Mendezi të gjashtë, në rast se merrnin ndokënd në pyetje. Shfaquni me vetëbesim, por të pafajshëm. Por ai e dinte nga informacionet e agjencisë se pjesëtarët e gardës mund të ishin të ashpër. Një problem mekanik shkaktoi një vonesë, dhe pjesëtarët e Gardës Revolucionare nisën të kthejnë vëmendjen nga pasagjerët e huaj. Mendezi u zhduk. Ai kishte një kontakt në aeroport dhe shkoi të pyesë për situatën e fluturimit të tyre. As nuk kish marrë ende përgjigjen se vonesa do të ishte e shkurtër, kur të gjithë dëgjuan

lajmërimin: “Swissair, fluturimi 363, gati për nisje të menjëhershme”. Teksa hipën në avion, Andersi vërejti fjalën AARGAU në pjesën e pasme të avionit: emri i rajonit zviceran ku e kish origjinën avioni ishte çuditërisht i ngjashëm me historinë e tyre. E goditi lehtë Mendezin në krah dhe i tha: “Ju përgatisni gjithçka, apo jo?” Mendezi buzëqeshi. Pasi avioni nisi të ngrihet në ajër, ai e dinte se sapo kishte realizuar operacionin më të suksesshëm të të gjithë karrierës së tij. Bari u hap sapo lanë pas hapësirën ajrore iraniane, dhe të gjithë porositën “Bloody Mary”. Mendezi ktheu kokën nga grupi dhe ngriti një dolli: “Jemi të gjithë në shtëpi, të lirë”. Pak orë më vonë, tek “Studio Six” ra për herë të parë zilja e telefonit të tretë. I tmerruar, Andi ngriti receptorin. “Mbaroi”, tha një zë i paidentifikuar. “Ia dolën”. – Ky artikull është publikuar fillimisht në Bota.al dhe është pjesë e arkivit të analizave historike të portalit. / bota.al

### Plani i Argo

Operacioni u projektua nga agentët e CIA-s, përfshirë specialistin e kamuflazhit Tony Mendez, për të nxjerrë këta gjashtë amerikanë nga Irani nën një identitet të remë: të paraqitjes si ekip i një filmi fantashkencë kanadez që po shkonte për të gjetur vende xhirimi në Iran.

### Si funksiononte ruseja

CIA krijoi një kompani të rreme produksioni filmash të quajtur Studio Six Productions dhe një film imaginar të quajtur „Argo“. Dokumentet, pasaportat kanadeze të falsifikuara, reklamimet e filmit në revista të industrisë dhe materialet plotësuan skenarin. Diplomatat amerikanë morën identitete të reja dhe u stërvitën të mbajërit rolin e anëtarëve të një skuadre produksioni filmash.

### Arritja e misionit

Mendez dhe kolegu i tij mbërritën në Teheran më 25 janar 1980 për të përgatitur gjashtë personat. Më 28 janar 1980, ekipi kaloi kontrollin e pasaportave në aeroportin e Teheranit dhe u nis me një fluturim drejt Zvicrës, duke shpëtuar kështu nga Irani.

### Sekreti dhe vlera historike

Operacioni ishte mbajtur fshehtë nga publikimi për shumë vite — vetëm në vitin 1997 u bë publik nga CIA si një nga shembujt më të suksesshëm të operacioneve të shpëtimit të agentëve. Rreth kësaj ngjarjeje u bë edhe filmi i famshëm „Argo“ (2012), i cili fiton çmime dhe dramatizon këto ngjarje.







## FFK-ja pranohet në Konventën e UEFA-s për licencën “Fitness B”

PRISHTINË, 4 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka marrë konfirmimin zyrtar nga UEFA për pranim në Konventën e Trajnerëve në nivelin shtesë të diplomës “Fitness B”, pas përfundimit me sukses të kursit të parë për “UEFA Fitness C” nga Departamenti i Edukimit në FFK. Në shkresën e UEFA-s, e

nënshkruar nga shefi i Zhvillimit të Trajnerëve në UEFA, Kris Van Der Haegen është konfirmuar se raporti pozitiv i vlerësimit për kursin inaugurues të “Fitness C” është shqyrtuar dhe miratuar nga paneli përkatës i UEFA-s, duke i hapur rrugë FFK-së për anëtarësim në këtë nivel të ri të Konventës. Me këtë

vendim, FFK-ja tashmë ka të drejtë të organizojë dhe të lëshojë diploma dhe licenca “UEFA Fitness B” për kandidatët që përmbushin kriteret dhe përfundojnë me sukses programin përkatës në përputhje me standardet dhe rregulloret e UEFA-s. Ky është një tjetër hap i rëndësishëm në avancimin e sistemit të edukimit të

trajnerëve në Kosovë dhe për ngritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e përgatitjes fizike. Departamenti i Edukimit në FFK do të vazhdojë të ofrojë programe cilësore dhe të harmonizuara plotësisht me standardet evropiane, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e futbollit në vend. Pranimi në nivelin



“Fitness B” dëshmon punën serioze dhe të qëndrueshme të FFK-së në ndërtimin e një strukture moderne të edukimit të trajnerëve.

## ‘DARDANET’ NISIN KUALIFIKIMET E BOTËRORIT ME FITORE BINDËSE NDAJ GJIBRALTARIT

PRISHTINË, 4 MARS - Kombëtarja e Kosovës në konkurrencën e femrave e ka nisur në mënyrën më të mirë të mundshme fushatën kualifikuese për Kampionatin Botëror 2027, duke shënuar fitore të thellë ndaj Gjibraltarit me rezultat 6:0, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë. Në ndeshjen e parë të Grupit 2 të Ligës C, “Dardanet” kanë dominuar plotësisht takimin dhe që nga fillimi ishte e qartë se fitorja nuk do të



vihej në dyshim.

Kaltrina Biqkaj e ka hapur serinë e golave që në

minutën e 4-t, duke i dhënë qetësi dhe siguri ekipit në vazhdim. Epërsinë e ka

dyfishuar Sara Sahiti në minutën e 26, që ishte goli i saj i parë në Kombëtaren A. Në pjesën e dytë “Dardanet” kanë vazhduar me ritëm të lartë dhe kontroll të plotë të lojës. Modesta Uka ka realizuar për 3:0 në minutën e 63-të, ndërsa kapitenia Erëleta Memeti ka shënuar golin e katërt në minutën e 72-të. Në minutat e fundit ka shkëlqyer Gentiana Fetaj, e cila ka realizuar dy herë (76’, 87’) për ta vulosur fitoren bindëse 6:0. Kosova bën

pjesë në Grupin 2 të Ligës C, ku në ndeshjen tjetër të kësaj xhiroje Kroacia ka shënuar fitore minimale 1:0 në udhëtim ndaj Bullgarisë. E pikërisht Kroacia do të jetë kundërshtarja e ardhshme e “Dardaneve”, ndeshje e cila zhvillohet të shtunën në Karlovac. Sipas formatit të garës, fituesi i grupit siguron kualifikimin në “play-off” dhe, njëherësh, avancojnë në Ligën B, ndërsa mundësia për “play-off” ekziston edhe për ekipin e vendit të dytë.

## SUNDERLANDI REALIZON SYNIMIN E PARË, “BBC”-ja: XHAKA KA PASUR NDIKIM TË MADH

